VENDIM
Nr. 223, datë 13.4.2023

PËR NJË SHTESË NË NUMRIN E PUNONJËSVE ORGANIKË NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE, PËR VITIN 2023, DHE PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR, MIRATUAR PËR VITIN 2023

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 12 e 14, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, për vitin 2023, shtohet me 27 (njëzet e shtatë) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm në 73 (shtatëdhjetë e tre) punonjës.

2. Numri rezervë i punonjësve, për vitin 2023, zvogëlohet me 27 (njëzet e shtatë) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm rezervë në 73 (shtatëdhjetë e tre) punonjës.

3. Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në grupin buxhetor nr. 87, "Institucione të tjera qeveritare", në programin "e-Qeverisja", i shtohet fondi prej 40 (dyzet) milionë lekësh, përkatësisht, 25 (njëzet e pesë) milionë lekë për shpenzime korrente dhe 15 (pesëmbëdhjetë) milionë lekë për shpenzime kapitale.

4. Fondi prej 40 (dyzet) milionë lekësh përballohet nga fondi rezervë i buxhetit.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku